




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSTOVA REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep: 2-D / DPK
Nr. Prot: 01-1762/2012
Br. Prot: 01-1762/2012
Data: 16.05.2012
Nr. flet: 02
Data: 16.05.2012

Republika e Kosovës



Republika Kosova - Republic of Kosova

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY**

DATË/A:	16.05.2012
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Bajram Kolgeci Menaxher i Zyrës së Prokurimit në Universitetin e Prizrenit
CC:	z. Mazllum Baraliu Rektor i Universitetit të Prizrenit
NGA/OD/FROM:	z. Hasan Preteni Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin "Ndërtimi i objektit montazhe dhe shërbimet hoteliere për UPZ"



Të nderuar

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pika 12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin "Ndërtimi i objektit montazhe dhe shërbimet hotelier per UPZ" numri prokurimit 10208-012-08-221 ofron këtë:

OPINION

Ju si autoritet kontraktues Zyra Prokurimit t'i ndërmerni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të cekura në arsyetim, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës nr. 04-L/042.

A r s y e t i m

Zyra e prokurimit në Universitetin e Prizrenit gjatë përgatitjes së Dosjes së tenderit ka shpallur tender për punë dhe shërbime hoteliere së bashku njëkohësisht duke mos bere dallimin, në këtë rast Autoriteti Kontraktues është dashur të bëj dallimin dhe të shpall tender të veçante për punë dhe tender tjetër për shërbime hoteliere dhe ti referohet ligjeve përkatëse për një prokurim te tillë.

Zyra e prokurimit me rastin e shpalljes së tenderit ka përdorur njoftimin për kontratë në Ueb Faqen e KRPP-së dhe Dosjen e tenderit sipas **Ligjit nr. 02/L-99** të cilat dokumente nuk janë valide ngase tash në fuqi është Ligji Nr. 04/L-042 dhe Legjislacioni dytësor. Me mos përdorimin dokumenteve në fuqi është bere shkelje e nenit **39** (Formularët Standard) dhe **27** (Dosja tenderit) të LPP-së 04/L-042. Autoriteti Kontraktues gjatë përgatitjes së Dosjes së Tenderit në faqen nr. 55/64 te Lista dokumenteve te Kërkesat për përshtatshmëri (neni 61), Kërkesat për përshtatshmëri Profesionale (neni 62) , Kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare (neni 63), Kërkesat për mundësit teknike / dhe profesionale (neni 64) ka përdorur **Ligjin 2003/17** edhe pse ky ligj deri më tash është ndryshuar tri (3) herë.

Autoriteti Kontraktues gjatë përgatitjes dosjes se tenderit si kriter për dhënie të kontratës ka përcaktuar tenderim me çmim ekonomikisht më të favorshëm :

- Çmimi i ushqimeve (shërbimeve) më i lirë 50 %
- Qiraja më e lartë që paguhet për UPZ 35%
- Projekti ideor më i mirë 15%

Gjatë analizës së këtij tenderi shihet se nën kriteret nuk kanë qenë të përgatitura ashtu siç kërkon LPP-ja ngase kanë qenë në kriteret të pa matshme (Projekti ideor më i mirë) gjë që nuk është në pajtim me nenin 52 LPP-së.

Në faqen nr. 63/64 Autoriteti Kontraktues gjatë përgatitjes së Dosjes së tenderit ka paraparë që nën kriteret ti përdor vetëm te shërbimet hoteliere ndërsa nuk dihet se çfarë kriteri ose nën kriteret ka paraparë të përdor për ndërtimin e objektit montazh.

Autoriteti Kontraktues nën kriteret i ka përdorur te njoftimi i kontratës i cili është publikuar në Ueb faqen e Krpp-së të cilin njoftim e ka inkorporuar edhe në dosje të tenderit mirëpo në dosje të tenderit nuk figuron fare aneksi 9 me të cilin identifikohen nën kriteret për dhënie të kontratës.

Në faqen nr.22/64 Autoriteti Kontraktues gjatë përgatitjes së Dosjes së tenderit ka kërkuar që shfrytëzimi i objektit montazhe është përcaktuar për 30 muaj me mundësi vazhdimi edhe për 30 muaj tjerë. Pas kohës së shfrytëzimit të objektit të ndërtuar objekti montazh do të mbetet pronë e UPZ-së. Shumë shpejtë UPZ do të ndërtoj Objektin e ri dhe Aneksin e ri objekte për nevoja të UPZ që nënkupton prishjen e kafiteris ekzistuese në anekse të ndërtesës së tanishme si dhe shkëputjen e kontratës me kafiterin ekzistuese në ndërtesën e vjetër të objektit të UPZ-së. Një kërkesë te tille me Ligji i Prokurimit Publike LPP-së 04/L-042 nuk e përcakton .

Autoriteti kontraktues te kërkesat për përshtatshmëri ka kërkuar certifikatën e Administratës Tatimore për obligimet e kryera të lëshuara pas datës 15.02.2006 dhe të dedikuar për këtë tender. Ne përpilimin e kësaj kërkesë te respektohet neni 65 i LPP-së 04/L-042.

Me respekt!

